



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 623/149 Prot.

Tiranë, më 04 09.2019

Lënda: Mbi miratimin e Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shkëmbimin e Informacionit me Eurojust

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA

TIRANË

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA

TIRANË

Bashkëlidhur ju përcjellim për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 140, datë 03.09.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për “*Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shkëmbimin e Informacionit me Eurojust*”.

Kjo rregullore është nxjerrë në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST ratifikuar me Ligjin nr. 113/2018

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 140, datë 03.09.2019

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT ME EUROJUST”**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “c” e “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 38 pika 2 shkronjat “c” dhe “k” e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 113/2018, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për “Për mbrojtjen e të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit me Eurojust”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri drejtuesit e prokurorive, prokurorët e të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM





RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT ME EUROJUST

Miratuar me Urdhrin nr. 140, datë 03.09 2019, të Prokurorit të Përgjithshëm

HYRJE

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “c” e “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 38 pika 2 shkronjat “c” dhe “k” e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 4 pika 1 e 9 pika 4 të Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it e ratifikuar me ligjin nr. 113/2018, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të tij, Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori”, e ndryshuar, Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme” dhe Rregulloret Standarde “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”,

KREU I

MBI KORRESPONDENCËN ME EUROJUST

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave administrative në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit midis Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust.

Neni 2

Administrimi i dokumentacionit

1. Administrimi i dokumenteve të krijuara apo të ardhura në zbatim të Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust dhe aksesit në to, kryhet në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Rregulloren për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Prokurori, Rregulloret e brendshme për

organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, si dhe këtë rregullore.

2. Korrespondenca ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Eurojust, do të regjistrohet në regjistrin manual sipas rregullave të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
3. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, do të mblidhen apo ruhen në sistemin elektronik të administruar nga prokuroria, vetëm të dhënat administrative të mjaftueshme për qëllime statistikore. Të dhënat personale në kuptim të nenit 1, shkronja “n”, të Marrëveshjes për Bashkëpunim me Eurojust, e datës 5 tetor 2018, do të përpunohen vetëm në kopje të printuar në letër.

Neni 3

Krijimi i regjistrit të posaçëm

1. Për regjistrimin e korrespondencës me Eurojust, në Prokurorinë e Përgjithshme krijohet regjistër i posaçëm që do të përmbajë të dhëna lidhur korrespondencën e dërguar në rrugë elektronike apo me postë zyrtare nga Eurojust për autoritetet shqiptare dhe anasjelltas. Modeli i regjistrit, është sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Regjistri shërben si protokoll i veçantë dhe administrohet sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të tyre.
3. Regjistri do të mbahet nga punonjësi i Sektorit të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, i ngarkuar posaçërisht. Në plotësimin e tij, nuk lejohet hedhja në asnjë formë e të dhënave personale të subjektit/subjekteve. Në përfundim të punës me të, regjistri mbyllet në kasafortë, kodet e të cilës ndërrohen periodikisht të paktën çdo gjashtë muaj.

Neni 4

Rregulla për shkëmbimin e informacionit

1. Pika e kontaktit, e caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm është personi përgjegjës për transmetimin e informacionit, për arritjen e qëllimit të Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it.
2. Gjatë shkëmbimit të informacionit me Eurojust, pika e kontaktit/prokurori i çështjes garanton:

- 2.1 të përdorë informacionin vetëm për dhe për aq kohë sa është e nevojshme, për të realizuar qëllimin për të cilin Eurojust e ka dhënë;
- 2.2 të përcaktojë në mënyrë të qartë në kërkesën drejtuar Eurojust, qëllimin për të cilin kërkon informacionin;
- 2.3 në rast të transferimit të paparashikuar të informacionit, të përcaktojë qëllimin përse është dhënë ky informacion;
- 2.4 të vendosë kufizime në përdorimin e informacionit të dhënë nga ana e tij dhe të respektojë kufizimet e vëna nga Eurojust;
- 2.5 të mos u komunikojë të tretëve, informacion të marrë nga Eurojust pa pëlqimin e tij dhe pa garanci në përputhje me nenin 7 të Rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori”. Në rastet kur pala tjetër kërkon pëlqimin për komunikimin palëve të treta të informacionit të marrë nga pala shqiptare, pëlqimi jepet me shkrim, nga prokurori i çështjes.
3. Në përputhje me detyrimet më sipër, të përfshihet në përgjigjet e kërkesave të paraqitura nga Eurojust, formulimi standard *“Kërkojmë që informacioni që përmbahet në këtë komunikim, të mos publikohet dhe të mos u bëhet i njohur personave të tretë të paautorizuar, si dhe të mos përdoret për asnjë qëllim tjetër të ndryshëm nga ai i shprehur në kërkesën tuaj, pa pëlqimin tonë”*.
4. Në përputhje me detyrimet më sipër, të përfshihet në kërkesën drejtuar Eurojust formulimi standard *“Informacioni që do të transmetohet në përgjigje të kësaj kërkesë për ndihmë juridike nuk do të përdoret, pa pëlqimin tuaj paraprak, për nevoja të tjera përveç se për hetimin penal të përmendur në këtë kërkesë”*.

Neni 5

Rregulla për Prokurorinë e Përgjithshme

1. Dokumentet hyrëse, pasi regjistrohen në regjistrin e korrespondencës me Eurojust, trajtohen pa vonesë nga Pika e Kontaktit, duke i përcjellë aktet sipas rastit, prokurorisë kompetente ose Eurojust.
2. Kërkesa dhe aktet shoqëruese të transmetuara nga Eurojust, mbyllën në zarf dhe i përcillen prokurorisë kompetente shoqëruar me shkresë përcjellëse. Shkresa përcjellëse nuk duhet të përmbajë të dhëna personale të subjekteve por vetëm informacionin e nevojshëm për realizimin e saj në një kohë sa më të shpejtë.
3. Në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk do të bëhet kopje e akteve por do të mbahet e arshivohet në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat, vetëm shkresa përcjellëse e praktikës.

Neni 6

Rregulla për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm

1. Me marrjen në dorëzim të një dokumenti të përcjellë sipas nenit 5, drejtuesi i prokurorisë, bazuar në informacionin e shkresës përcjellëse dhe pa u njohur me aktet (në zarf), i cakton praktikën për ndjekje prokurorit që ndjek çështjen ose e shorton atë sipas rregullave në fuqi duke garantuar aksesin në informacion vetëm nga ky prokuror dhe kur sipas objektit të kërkesës është e nevojshme, edhe oficerit të policisë gjyqësore të ngarkuar për kryerjen e veprimeve.
2. Me përfundimin e veprimeve, aktet në ekzekutim të kërkesës i përcillen pa vonesë Pikës së Kontaktit.

KREU II

RREGULLA LIDHUR ME GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 7

Kufizimi i transmetimit të të dhënave sensitive

1. Regjistrat që administrohen në prokurori, nuk duhet të pasqyrojnë në asnjë nga rubrikat e tyre informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.
2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë hetimore, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore pasqyrojnë në akte, të dhëna sensitive vetëm në rast se dhe në masën që, janë të nevojshme për realizimin e qëllimit të hetimit.
3. Prokurori i ngarkuar me çështjen garanton mosdhënien e informacionit lidhur me të dhënat personale që zbulojnë origjinën etnike ose raciale, mendimet politike ose besime fetare ose besime të tjera, anëtarësimin në sindikata ose në lidhje me shëndetin dhe jetën seksuale, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është rreptësisht e nevojshme për qëllimin e bashkëpunimit.

Neni 8

Aksesi në të dhënat personale

Përveç sa parashikohet në nenin 8 të Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori, në kuadër të shkëmbimit të informacionit me Eurojust, prokurori i ngarkuar me çështjen garanton të drejtën për akses, të çdo personi të dhënat e të cilit janë përpunuar ose po përpunohen në prokurori, duke i dhënë informacionin e kërkuar subjektit të të dhënave, në një kohë sa më të shpejtë por jo më shumë se 30 ditë (nga marrja e kërkesës), ose duke i shpjeguar atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Neni 9

E drejta e korrigjimit, bllokimit dhe fshirjes

1. Përveç sa parashikohet në nenin 8 të Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori, në kuadër të shkëmbimit të informacionit me Eurojust, prokurori i ngarkuar me çështjen garanton që, në rastet kur subjekti i të dhënave ka kundërshtuar të dhënat e tij personale, të kufizojë përdorimin e të tyre deri në verifikimin e pretendimeve të subjektit. Kur i vlerëson pretendimet të bazuara, prokurori bën korrigjimet përkatëse. Prokurori informon subjektin e të dhënave për korrigjimin, bllokimin ose fshirjen e të dhënave të kundërshtuara prej tij.
2. Prokurori, njofton menjëherë palën/palët që u ka transmetuar këto të dhëna, për pasaktësitë e konstatuara.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

REGJISTRIMI			TË DHËNA MBI KËRKESËN					VEPRIME GJATË EKZEKUTIVIT			
Nr. rëndor	Nr. Prot	Data	Autoriteti që paraqet kërkesën (numri dhe data e kërkesës, emërtimi i institucionit/autoritetit kërkuar, shteti kërkuar)					Përmbajtja e kërkesës	Vepra/Veprat penale	Institucioni/Prokuroria kompetente për ekzekutimin	Punonjësi që e ndjek praktikën
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	

Ne kolonën 1 shkruhet numri rëndor i praktikës
 Ne kolonën 2 shkruhet numri i plotë që merret dokumenti në PP ditën e evidentimit. Në numrin e plotë shkruhen fraksionet e numrit të plotë që marrin të gjitha dokumentet e një praktike deri në mbylljen e saj
 Ne kolonën 3 shkruhet data e protokollimit në PP, për çdo dokument të kësaj praktike, hyes dhe datës
 Numrat 4, 5, 6, 7 plotësohen vetëm për dokumentin e autoritetit dërgues. Ne kolonën 4 shkruhet numri i protokollit të institucionit kërkuar ose numri i dosjes /shtjësjes/referencës së autoritetit kërkuar
 Ne kolonën 5 shkruhet data e shkrësës së autoritetit që paraqet kërkesën
 Ne kolonën 6 shkruhet emërtimi i institucionit/autoritetit kërkuar
 Ne kolonën 7 shkruhet shteti kërkuar
 Ne kolonën 8 shkruhet të dhëna mbi objektin e kërkesës apo veprimet që kërkojnë të kryhen
 Ne kolonën 9 shkruhet vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi penal përkatës
 Ne kolonën 10 shkruhet autoriteti/prokuroria kompetente se ciles i dërgohet për ekzekutim kërkesa
 Ne kolonën 11 shënohet prokurori që ndjek praktikën
 Ne kolonën 12 shënohet ekzekutori dhe data kur janë sjelle aktet në ekzekutim nga Prokuroria përkatëse a
 Ne kolonën 13 mund të shënohen të dhëna si psh. arsyet e moskëzimit të një leterporosie, etj.

Ne evidentimin e një praktike, poshtë numrit të plotë rezervohen rreshtat për të regjistruar dokumentet me fraksion të praktikës së dhënë. Praktikant mblidh pyetje ndahen nga njera-tjetra me një vijë të trashë. Kur lind nevoja, praktika mund të transferohet në një faqe tjetër të regjistrit duke vënë shenimin

IT	
Rezultati (eshte ekzekutuar apo jo) dhe data e ekzekutimit	Shënime
12	13

:"Kalon ne faqen ..."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 623/ Prot.
50

Tiranë, më 04.09.2019

Lënda: Mbi implementimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST ratifikuar me Ligjin nr. 113/2018

MINISTRISË SË DREJTËSISË

TIRANË

Në kuadër të implementimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust ratifikuar me Ligjin nr. 113/2018, ju përcjellim bashkëlidhur për dijeninë tuaj urdhrin nr. 140, datë 03.09.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për “*Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shkëmbimin e Informacionit me Eurojust*”. Hartimi i kësaj Rregulloreje u realizua në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Eurojust, të Ministrisë së Drejtësisë si dhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në kuadër të implementimit të Marrëveshjes me Eurojust (masa për të cilat është vënë në mënyrë të vazhdueshme në dijeni dhe Ministria e Drejtësisë ashtu edhe Eurojust).

Për sa më sipër sugjerojmë që nga ana e Ministrisë së Drejtësisë t’i dërgohet njoftimi zyrtar Eurojust për zhvillimin e vizitës inspektuese nga ana e përfaqësuesve të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

Konc. M. Imeraj
Miratbi: A. Xhok
Dt. 04.09.2019
Nr. i Kopjeve: 2